

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
ERISELDA SEFA

Relacion Teknik

Objekti: " Rindertim i rruges "Lasgush Poradecit"segmenti pas
perroit"

Lagjia : "18 Tetori"

Bashkia Lushnje

1) ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

a) HYRJE

Ne kuadrin e zhvillimeve ekonomiko-shoqerore dhe kerkesave urbane te qytetit te Lushnjes nevoja per permiresimin e rrjetit rrugor eshte nje kerkese urgjente. Rruga "Lasgush Poradeci" e ka te domosdoshme nderhyrjen pasi gjendja e saj eshte e degraduar.

2.OBJEKTI I RELACIONIT

Mbeshtetur ne detyren e projektimit dhe kerkesat e Bashkise Lushnje objekti i ketij relacioni teknik eshte paraqitja e projekt zbatimit ku prezantohen masat dhe zgjidhjet e nevojshme planifikuese,arkitektonike dhe inxhinierike qe jane parashikuar ne projekt per elemente te ndryshem te tij, zgjidhje urbane, problemet arkitektonike dhe inxhinierike si : shtresat rruges ,bordurat, rrjeti inxhinierik, ndricimi.

Bazuar ne azhornimin ne terren,shqyrtimin e dokumentave perkates u realizua projekt zbatimi.

3.ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

a) Analiza urbane

Nga pikëpamja urbane, rruga qe perfshin projekti ndodhet në lagjen " 18 Tetori", ne qytetin e Lushnjes. Kjo rruge lidh dy akset me te rendesishme te qytetit te Lushnjes, "**Autostraden e Tiranes**" me rrugen "**Vath Korreshi**".

Gjithashtu duhet permendur e gjithë hapësira qe pershkon kjo rruge rrethohet nga godina banimi te tipit shtepi banimi 2,3 dhe 4 kate dhe kufizohet me mure rrethuese.

b) Analiza arkitektonike

Ne aspektin arkitektonik sic e permendem dhe me larte rruga eshte ne gjendje jo te mire ne te gjithë elementet perberes se saje. Mungojne shtresat rrugore, bordurat e rruges, trotuaret dhe ndricimi . Rruga ka qene e shtruar me shtrese asfalti ,e cila me perdorimin e rruges eshte demtuar .Te dukshme jane materiale prej guri dhe granili te hedhur vazhdimisht per mbulimin e gropave nga demtimet pa asnje kerkese arkitektonike, si forma, ngjyra dhe funksionale. Terreni eshte fushor. Gjatesia e pergjithshme eshte 730 ml dhe me gjeresia ndryshon dhe varion 4 m-5 m .Ne pjesen me te madhe te rruges kufizimi i rruges behet nga muret rrethuese te banesave .Banesat te ndertuara ne kete rruge jane pothuajse te gjitha te reja te tipit vila.


Rruga eshte parashikuar te zgjerohet ne nje ane , respektivisht ne anen e perroit te thate .Paketa e shtresave eshte shtuar ne pjesen e shtesen pasi kemi te bejme me nje trup rruge te re .

Ne anen e zgjerimit te rruges kemi nje disnivel midis rruges dhe tokes natyrale per pasoje eshte planifikuar ndertimi i nje muri mbajtes pergjate rruges por jo ne te gjithë gjatesine .

Ne projekt eshte parashikuar dhe zgjerimi i urave si domosdoshmeri pasi kemi zgjerimin e trupit te rruges .

Ne profilin e ri te rruges eshte parashikuar korsia e makinave me gjeresi 6m, trotuar ne njeran ane me gjeressi 1.5m dhe ne anen tjeter 1m si dhe pista e bicikletave me gjeresi 1m.

Foto te gjendjes ekzistuese



c) Analiza inxhinierike

Kanalizimet e ujrave të bardha (K.U.B) mungojne dhe ato rrjedhin ne menyre natyrale duke krijuar nje situate te veshtire ne kohe rreshjesh per banesat qe ndodhen ne kete rruge. Kanalizimet e ujrave te zeza mungojne ,derdhja e ujerave realizohet nepermjet gropave septike .

Mungojne shtresat rrugore dhe rruga eshte mjaft e demtuar. Eshte nje rruge ku mungojne trotuaret ne te dyja anet ne te gjithë gjatesine e saj .

Konkluzione

Mbeshtetur ne problematiken e gjendjes ekzistuese dhe nga kerkesat e shtruara nga Bashkia Lushnje konform planit te zhvillimit te qytetit dhe rivleresimit qe kerkon hapësira ku do te ndertohet kjo rruge, u studiuuan dhe u paraqiten ne kete projekt e gjithë problematika e zones e cila do te trajtohet ne faza te ndryshme.

4. KUSHTET KLIMATIKE DHE HIDROLOGJIKE

a) Kushtet klimatike

Zona e Lushnjes, ashtu si edhe i gjithë vendi ynë, karakterizohet nga një shpërndarje jo e barabartë e reshjeve gjatë muajve dhe stinëve të ndryshme të vitit. Kjo shpërndarje e ka burimin në karakterin mesdhetar të klimes në këtë zonë. Reshjet më të shumta bien në stinën e Dimrit e të Vjeshtës, ndërsa Vera paraqitet me reshje të pakta.

b) Kushtet hidrologjike

Vrojtimit e nivelit të ujit nëntokësor në zonën e Lushnjes behen në puse me tuba dhe në puse të zakonshme. Edhe në këtë zonë nivelet e ujit nëntokësor ndjekin andamentin e reshjeve.

Rritjen më të madhe të nivelet e ujit nëntokësor e kanë në muajin Nëntor, mbas kësaj nivelet kanë qendruar afër sipërfaqes së tokës deri në Mars kur fillojnë të ulen pothuajse në të gjithë zonën e Lushnjes.

Në diagramet e ndryshme të hartuara nga institucionet shkencore të vendit tone paraqiten nivelet mesatare mujore shumëvjeçare dhe nivelet mesatare mujore.

Amplituda mesatare për zonën e Lushnjes është nxjerre nga pikat e vrojtimit në zonë të ndryshme të qytetit.

Reshjet atmosferike me karakteristikat e tyre si intensitet rënies dhe zgjatja në kohë luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e shkallës së erozionit, llogaritjen e parametrave të kanaleve kullues apo edhe të kanalizimeve të qyteteve.

Pikerisht për shkak të rëndësise së madhe të tyre, studimi i intensitetit të shirave për kohezgjatje dhe periudhë perseritjeje të ndryshme është një element i domosdoshëm.

Kushtet hidrologjike që përcaktojnë rregjimin e rrjedhës ujore, dhe në vecanti rrjedhën maksimale që më së shumti na intereson për këtë projekt, varen nga një numër faktorësh, ku më kryesoret janë:

- Klima.
- Topografia.
- Pedologjia.
- Përdorimi i tokës.
- Shkalla e urbanizimit të sipërfaqes.

Në faktoret klimatike, përcaktohet në rastin tone janë rreshjet e shiut. Të dhenat mbi rreshjet janë marrë nga matjet e kryera në stacionet lokale.

6 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

a) ZGJIDHJA E PLANIFIKIMIT URBAN KONSISTON NË:

- Ruajtjen e gjurmës ekzistuese të rrugës dhe zgjerimi i rrugës në njërën anë ;
- Përmirësimin e treguesve teknik, në planimetri dhe në altimetri ;
- Përmirësimin e profilit të rrugës si dhe të shtresave të saj.

b) PLANIMETRIA E RRUGES

Ne kontekstin e zhvillimit planimetrik dhe ne zbatim te detyres se projektimit per rikonstruksionin e rruges, duke respektuar karakteristikat gjeometrike ekzistuese, kemi permiresuar parametrat gjeometrik dhe teknik brenda mundesive qe ofrojne kushtet territoriale ,duke synuar ne gjeresine e rruges 8.5 m se bashku me trotuaret .Gjurma e rruges e propozuar eshte 6 m dhe trotuaret nga 1.5 m ne njeren ane dhe ne ann tjeter 1 m si dhe pista e bicikletva 1m.

Ne planimetrine e projekt zbatimit te objektit bashkengjitur ketij relacioni jane materializuar keto permiresime:

- Ne paketen e vendosur te shtresave jane marre parasysh te gjithe faktoret qe nevojiten per llogaritjen e tyre si trafiku ne raste sherbimesh dhe emergjencash, klima, bazamenti etj.

c) ZGJIDHJA ARKITEKTONIKE

- Rruga do jet me dy pjerresi dhe ujrat do te mbidhen ne te dyja ane te rruges me kunete anesore dhe me puseta shimbledhese. Shtresat rrugore do te vendosen pasi te jete bere nje skarifikim sipas profilit gjatesore te rruges . Per sa i perket shtresave rrugare te trupit te rruges , rruga eshte trajtuar me dy pjese pasi rruga eshte parashikuar te zgjerohet ne njeren ane . Per sa i perket pjeses se rruges qe eshte ekzistuese , shtresat ne te jane parashikuar te jene si me posht:

- **Shtrese asfaltobetoni 3cm**
- **Shtrese binderi 5 cm**
- **Shtrese stabilizanti 10 cm**
- **Shtrese çakelli 10 cm.**

Dhe ne pjesen e zgjerimit te rruges jane prashikuar shtresa rrugore shtese pasi kemi te bejme me trup rruge te re :

- **Shtrese asfaltobetoni 3cm**
- **Shtrese binderi 5 cm**
- **Shtrese stabilizanti 10 cm**
- **Shtrese çakelli 10 cm.**
- **Shtrese cakelli 10 cm**
- **Shtrese çakelli 20 cm.**

Trotuaret jane parashikuar te ndertohen ne te dyja anet .Ne njeren ane trotuari ka gjeresi 1.5m dhe ne anen tjeter 1m. Shtresat e trotuarit jane parashikua te jene :

- **Trotuar me pllaka me 6 cm beton**
- **Shtrese zhavori 10 cm**
- **Shtrese stabilizanti 10 cm**

Pista e bicikletave eshte parashikuar te ndertohet ne njeren ane .Gjeresia e pistes se bicikletave eshte 1m dhe eshte parashikuar te kete keto shtresa:

- **Shtrese betoni 10cm**
- **Shtrese zhavori 10 cm**
- **Shtrese stabilizanti 10 cm**

Ne projekt eshte parashikuar dhe ndricimi i rruges me shtylla metalike ndricimi per gjate gjithe rruges . Shtyllat do te vendosen ne njeren ane .Lartesia e shtyllave do te jete 7ml.

Trotuaret jan parashikuar te ndertohen ne te dyja anet .Ne njeren ane trotuari ka gjeresi 1.5m dhe ne anen tjetet 1m. Shtresat e trotuarit jane parashikua te jene :

- **Trotuar me pllaka me 6 cm beton**
- **Shtrese zhavori 10 cm**
- **Shtrese stabilizanti 10 cm**

d). Rrjete inxhinierike

- K.U.B

Drenazhimi i ujrave sipërfaqesore eshte parashikuar te realizohet nepermjet pjerresise terthore te rruges dhe trotuareve duke i mbledhur ujrat neper kunetat e betonit ne te dyja anet e rruges. Kunetat i shkarkojne prurjet e tyre ne puseta shimbledhese me permasa 40x40 cm .Ujrat me pas derdhen ne pusetat e kontrollit me permasa 1x1x1.5 m te vendosura afersisht cdo 50 m. Dimensionet e pusetave jane kushtezuar nga arsye konstruktive, si dhe per te krijuar kushte sa me te pershtateshme per punimet e mirembajtjes dhe pastrimit. Rrjeti i kanalizime kryesor eshte parashikuar te jete me tub HDPE i brinjezuar SN8 me dimension Ø400 dhe lidhja e kunetave me rrjetin kryesore do te behet me tub HDPE i brinjezuar SN8 Ø200 dhe nepermjet kusetave te kontrollit. .Derdhja e KUB-se do te behet ne perroin e qytetit qe ndodhet ne fillim te rruges.

Ne projekt eshte i trajtuar ne menyre te detajuar rrjeti i KUB-se si ne planimetri dhe ne profiling gjatesore .

Konkluzione.

Duke mare ne konsiderate sygjerimet e bera nga Drejtoria e Planifikimit u studiuua dhe u paraqiten ne kete projekt zbatim planimetria e propozuar, profili gjatesor, seksione terthore tip , profilet terthore si dhe projektin e sistemimit te ujerave te bardha.

Drejtoria e Planifikimit
Mimoza Haxhiu